

PER

PROJEKTVENDIMIN

**“PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 559, DATË 29.7.2022, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE DHE TARIFAVE PËR
DHËNIEN NË SHFRYTËZIM/PËRDORIM TË FONDIT PYJOR KOMBËTAR, PËR
VEPRIMTARI EKONOMIKE, SI DHE PËR PRODHIMET DRUSORE DHE
JODRUSORE PYJORE”**

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i çmimeve dhe tarifave për prodhimet drusore dhe jo drusore, në fondin pyjor nga ushtrimi i veprimtarive ekonomike.

Objektivi që synohet të arrihet është përdorimi/shfrytëzimi i qëndrueshëm i fondit pyjor kombëtar, duke marrë në konsideratë se pyjet janë një burim ekonomik që sjellin zhvillim, punësim, për të gjithë sektorët kryesorë të ekonomisë (bujqësi, industri, energji, turizëm, argëtim, etj.), ndaj përdorimi dhe përfitimi i të mirave duhet të jetë: (i) i qëndrueshëm në raport me mundësinë; (ii) i optimizuar sipas vlerës së përdorimit; (iii) i shpërndarë në mënyrë të drejtë në raport me investimin, punën dhe riskun e marrë përsipër; (iv) duke patur si prioritet, shtresat në nevojë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është një shtesë në VKM nr. 559/2022, i cili ishte i parashikuar në Programin Analitik të Projektakteve, për vitin 2022, në zbatim të nenit 25 dhe 27, të Ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë.
Projektvendimi gjen mbështetje dhe është në një linjë me përcaktimet/drejtimitet e dhëna nga dokumente të tjera për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, si SKZHI-ja 2020, dokument kryesor strategjik kombëtar që mbështet zhvillimin e

Relacion për projektvendimin “Për një shtesë në vendimin nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”

... dhe v. nr. 814, datë 31.12.2018
“Për miratimin e dokumentit të politikave për pyjet në Shqipëri, 2019–2030”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Pyjet si pasuri kombëtare, kanë peshë dhe rëndësi të veçantë në zhvillimin dhe progresin e vendit, ndaj duhen pozicionuar në një linjë me politikën dhe objektivat strategjike të zhvillimit kombëtar, me kontribut të qenësishëm, duke zhvilluar sektorin nëpërmjet një sistemi të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave, strategjive, programeve, dhe planeve të mbarështimit, duke integruar dhe optimizuar interesat midis përdoruesve dhe mundësive të përdorimit/shfrytëzimit të fondit pyjor.

Propozimi i këtij vendimi del si domosdoshmëri për rregullimin financiar të përfitimeve nga prodhimi dhe shfrytëzimi i prodhimeve jodrusore nga pylli, përfitimeve nga prodhimi dhe shfrytëzimi i materialit drusor, dhe ndryshimin e disa tarifave sipas çmimeve të tregut që kanë ndryshuar ndër vite për drutë e zjarrit për plotësimin e nevojave të popullsisë, Për sa më sipër, vendimi i propozuar do të sjellë një administrim më të mirë të sektorit dhe fondit pyjor kombëtar, duke patur si pritshmëri për të ardhmen, mundësimin e efekteve financiare pozitive në për plotësimin e nevojave të popullsisë me dru zjarri për përballimin e krizës energjitike.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi mbështetet në nenin 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 25, dhe të pikës 5 të nenit 27, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet” dhe vjen si bashkëpropozim i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BE-së (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Akti i propozuar nuk synon të përafrojë asnjë dokument të *acquis e BE-së*, pasi është akt që bazohet në legjislacionin e brendshëm të vendit.

Relacion për projektvendimin “Për një shtesë në vendimin nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”

PROJEKTAKTIT

Nëpërmjet këtij projektakti, parashikohet përcaktimi i tarifave bazë për çmimet dhe tarifën për prodhimet drusore dhe jo drusore, dhe specifiku për drutë e zjarrit.

Pas hyrjes në fuqi të vendimit 559/2022, vërehet një rritje e konsiderueshme e çmimit të drutave të zjarrit të cilat nevojiten për plotësimin e nevojave të popullsisë për ngrohje.

Të ndodhur para këtij fakti dhe me mungesa të theksuara të lëndës drusore për ngrohje, veçanërisht në bashkitë e zonës juglindore të Shqipërisë, me synim krijimin e një fashe mbrojtëse për konsumatorin, është propozuar si zgjidhje një shtesë në VKM aktuale nr. 559/2022, për lëndën e cila ka rezultuar e dëmtuar nga zjarret, por që ka vlera për përdorim si dru zjarri. Në këtë rast tarifa ulet me 40% krahasuar me vlerën e lëndës drusore në këmbë të padëmtuar.

Në projektvendim, në pikën 1, është parashikuar vetëm një shtesë në shtojcën nr. 3 të VKM nr. 559/2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore” ku, pas tabelës shtohet shënimi :
Kur drutë e zjarrit janë nxjerrë nga sipërfaqe të djegura, të evidentuara sipas dokumentacionit tekniko-ligjor përkatës, por materiali drusor është i përdorshëm, tarifën për to do të jenë 40% më e ulët se tarifën bazë.

Nëpërmjet këtij përcaktimi parashikohet që, në rastet kur ka patur rënie zjarri të cilat janë evidentuar sipas dokumentacionit tekniko-ligjor nga strukturat e menaxhimit të pyjeve në bashki dhe janë bërë azhurnimet kadastrale të cilat miratohen nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve, tarifën bazë për materialin drusor që mund të përdoret nuk mund të jenë të njëjta me ato të sipërfaqeve të pa përshtuara nga zjarri dhe për pasojë edhe çmimi i shitjes do të jetë më i ulët.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve.

Relacion për projektvendimin “Për një shtesë në vendimin nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”

NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e këtij projektvendimi kanë kontribuar specialistët e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Mjedisit, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave dhe Sektori i Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore) si dhe është koordinuar me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi ky akt del si bashkëpropozim edhe me ministrin përgjegjës për financat dhe ekonominë.

Projektvendimi, pas bashkëfirmosjes, do të dërgohet për mendim në ministritë e linjës, nëpërmjet sistemit *e-aktet*, konkretisht në Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë dhe në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Gjithashtu, ky projektvendim do përcillet me shkresë zyrtare për mendim edhe në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për shqyrtim nga Këshilli Konsultativ.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektvendimi nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, por do të çojë në rritje të të ardhurave për buxhetin e njësive të vetëqeverisjes vendore.

PROPOZUESIT


MINISTËR,

Mirela KUMBARO FURXHI



MINISTËR

Delina IBRAHIMAJ



Relacion për projektvendimin "Për një shtesë në vendimin nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore"